



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 325/₄ Prot

Tiranë, më 19/3/2021

VENDIM

Nr. 17, datë 19.3.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. (në vijim “ankuesi”) ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 325 Prot., datë 12.02.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet e-mail-it datë 06.01.2021, depozituar në adresën elektronike argid.alikaj@oshee.al, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Sa është numri i rekurseve në Gjykatën e Lartë të bëra nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (në vijim, “OSHEE”) gjatë viteve 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 (të ndara sipas viteve).
2. Sa është numri i kërkesave për pezullim ekzekutim vendimi të bëra nga OSHEE para Gjykatës së Lartë për vitet më sipër.

Në mungesë të një përgjigje nga Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 325/1 prot., datë 16.02.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik sqarime në lidhje me trajtimin apo procedurën e ndjekur për kërkesën për informacion.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1670/1 Prot., datë 01.03.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 325/2 Prot., datë 03.03.2021, ka sqaruar ndër të tjera se: *“...Informacioni i kërkuar nuk është informacion publik por informacion i brendshëm i shoqërisë OSHEE, informacion i cili është rezultat i veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Ky informacion mund të raportohet pranë organeve si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e aksionerit të shoqërisë OSHEE, Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë, Auditi i Brendshëm i shoqërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe me organet e hetimit dhe gjykimin sipas vendimeve dhe kërkesave përkatëse...”*

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar me ankimin nr. 325/3 Prot., datë 08.03.2021, duke theksuar ndër të tjera se: *“...Në rastin konkret informacioni i kërkuar është informacion i cili ka të bëjë me veprimtarinë e autoritetit publik, dhe si i tillë është informacion publik. Mbi të gjitha informacioni i kërkuar publikohet edhe në faqen e Gjykatës së Lartë, pra jo vetëm që nuk është informacion i brendshëm i shoqërisë por është publik...”*

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin citohet se: *“Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, si edhe bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar si pasojë e përhapjes së COVID-19, në zbatim të masave të marra nga institucionet përkatëse, seanca dëgjimore u zhvillua nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik (on-line/video-call), në datën 17.03.2021, ora 11.30 me prezencën e përfaqësueses së ankuesit dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër. Gjithashtu, përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimin e reflektuar në shkresën nr. 1670/1 Prot., datë 01.03.2021, si dhe sqaruan ndër të tjera se: *“...dokumenti i kërkuar nuk konsiderohet dokument zyrtar pasi nuk plotëson elementët e përcaktuar ligjor, rrjedhimisht Autoriteti Publik nuk ka detyrim sipas pikës 3 të nenit 3 të LDI në të cilin parashikohet se: “ Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit”. Në kuptim të kësaj dispozite, ky informacion nuk disponohet në formën e kërkuar, por duhet të përpunohet. Ankuesi, këtë informacion, mund t'a marrë në Gjykatën e Lartë...”*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit nuk qëndrojnë.

Konstatohet se, fillimisht Autoriteti Publik me shkresën nr. 1670/1 Prot., datë 01.03.2021, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 325/2 Prot., datë 03.03.2021, mban qëndrimin se: *"...Informacioni i kërkuar nuk është informacion publik por informacion i brendshëm i shoqërisë "OSHEE"..."*

Në shkronjën b) të pikës 1 të nenit 2, të LDI parashikohet se: *"Autoritet publik" b) janë shoqëritë tregtare ku: i) shteti zotëron shumicën e aksioneve; ii) ushtrohen funksione publike, sipas parashikimit të shkronjës "c" të kësaj pike".*

Në kuptim të këtij parashikimi, OSHEE është Autoritet Publik dhe subjekti i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës, pavarësisht se informacioni i prodhuar është si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, legjislacioni i cili nuk parashikon përjashtimin e OSHEE nga zbatimi i detyrimeve që burojnë nga LDI.

Lidhur me pretendimin e ngritur në seancën dëgjimore nga përfaqësuesit e Autoritetit Publik, sipas të cilëve nuk ekziston një dokument statistikor bazuar në kërkesën për informacion, por duhet prodhuar një dokument i ri, pranohet disponimi i informacionit, por jo në formatin e kërkuar. Në këto kushte, bazuar në pikën 2, të neni 2 të LDI, ku parashikohet se: *"Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik"*, Komisioneri vlerëson se, këto dokumente, përbëjnë informacion publik dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të vendosen në dispozicion të kërkuarit/ankuesit në formatin e disponuar, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të LDI.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit vlerëson se, argumenti i përfaqësuesve të Autoritetit Publik, se subjekti mund të kërkojë informacionin për lehtësi, në Gjykatën e Lartë, nuk qëndron.

Në pikat 2 dhe 3 të nenit 12 të LDI, parashikohet se:

2. *"Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendrike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuarin."*

3. *Arsyeja e vetme që justifikon dërgimin e kërkesës një autoriteti tjetër është mungesa e informacionit të kërkuar. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa për informim, njofton kërkuarin se kërkesa e tij i është dërguar një autoriteti tjetër, si dhe e informon atë për kontaktet e autoritetit ku është dërguar kërkesa."*

Sa më sipër, parashikohet gjithashtu dhe në germën “d”, të pikës 2, neni 10 i LDI, sipas të cilit “koordinatori për të drejtën e informimit dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”.

Në pikën 3 të nenit 3 të LDI parashikohet se, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkzionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, neni 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 325 Prot., datë 12.02.2021 të Qendrës “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit bazuar në kërkesën për informacion datë 06.01.2021, në formatin e disponuar, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (1.Sa është numri i rekurseve në Gjykatën e Lartë të bëra nga OSHEE gjatë viteve 2014, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020 (të ndara sipas viteve. 2.Sa është numri i kërkesave për pezullim ekzekutim vendimi të bëra nga OSHEE para Gjykatës së Lartë për vitet më sipër), brenda datës 29. 3 .2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 19. 3 .2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

